



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1712 prot.

Tiranë, më 20.12.2019

VENDIM
Nr. 192, datë 20.12.2019

“PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 160, DATË 10.12.2019, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Gjykatës së Lartë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion në institucionin e Gjykatës së Lartë. Ky institucion nëpërmjet shkresës nr. 3044/1 prot., datë 04.09.2019 ka raportuar se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunëset:

- ***** - “*Përgjegjëse*” në Sektorin e Rregjistrimit ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 27.01.2018.
- ***** - “*Përgjegjëse*” në Sektorin e Financës ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.09.2018.

Në vijim, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 160, datë 10.12.2019, ka vendosur:

“1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Gjykatës së Lartë marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit e mëposhtëm:

- ***** - “Përgjegjëse” në Sektorin e Rregjistrimit ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 27.01.2018.
- ***** - “Përgjegjëse” në Sektorin e Financës ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.09.2018.

2. Pozicionet respektive të punës, të shpallen menjëherë pozicione të lira dhe të fillojnë procedurat për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.

3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim.

...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 160, datë 10.12.2019, “Mbi paralajmërimin e institucionit Gjykata e Lartë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, institucioni i Gjykatës së Lartë përmes shkresës së dërguar me nr. 2931/1 prot., datë 17.12.2019, me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1712/2 prot., datë 18.12.2019, ka informuar këtë të fundit, në lidhje me situatën në të cilën ndodhet shërbimi civil gjyqësor i Gjykatës së Lartë si dhe mbi problematikat me të cilat përballet Gjykata e Lartë në ushtrimin e funksioneve të saj.

Konkretisht, në Gjykatën e Lartë ka vakanca në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil duke krijuar një volum pune të pazakontë përsa i përket menaxhimit të çështjeve gjyqësore, duke qenë se, Këshilltarët ligjorë dhe sekretaria gjyqësore vijnë të punojnë intensivisht për përpunimin dhe përgatitjen e dosjeve gjyqësore për relativim, në mënyrë që të përballohet numri i çështjeve nga trupat gjyqësore, i cili aktualisht është një numër i konsiderueshëm.

Njëkohësisht, si rezultat i funksionimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organ i cili e ushtron aktivitetin e tij kushtetues dhe ligjor në selinë e Gjykatës së Lartë, referuar nenit 219 dhe nenit 230, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, një pjesë e madhe e stafit administrativ të Gjykatës së Lartë siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe detyrave të këtij organi.

Gjithashtu në kushtet kur, struktura dhe organika e shërbimit civil gjyqësor të Gjykatës së Lartë, do të ndryshojë si rezultat i implementimit të kuadrit të ri ligjor që rregullon shërbimin civil gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit nënligjor nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të cilat më pas do të kalojnë për miratim nga Këshilli i Gjykatës së Lartë në përputhje me nevojat e tij, vlerësohet se, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës për punonjësit që kanë mbushur moshën për daljen në pension të plotë pleqërie, do të vështirësonte akoma më shumë punën e strukturave të institucionit të Gjykatës së Lartë si dhe organit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Nga ana tjetër, pozicionet vakante të krijuara për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil të këtyre punonjësve, nuk do të mund të plotësoheshin me rekrutimet e punonjësve të rinj sikurse e kërkon ligji për shërbimin civil, në kushtet kur ende nuk është hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lista e nëpunësve civilë gjyqësorë, mbi bazën e të cilës kryhet edhe pranimi në shërbimin civil gjyqësor.

Në analizë të kuadrit të ri ligjor dhe nënligjor, i cili rregullon fushën e organizimit të shërbimit civil gjyqësor, vërejt se:

Referuar ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, kreu IV, “Funksionimi i administrimit gjyqësor”, neni 36, “Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor”, parashikohet se:

“Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në kompetencë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat lidhen me administrimin gjyqësor, sipas kompetencave të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë””.

Në vijim, në nenin 38, germa c), të ligjit nr. 98/2016, “Kompetencat e Këshillit të Gjykatës”, sanksionohet se:

“Këshilli i Gjykatës ka kompetencat e mëposhtme:

...

“c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë”

...”

Ndërsa në seksionin V, neni 80, “Ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Ndërprerja e marrëdhënieve në shërbimin civil gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil”, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

...

3. Organi kompetent për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë është Këshilli i Gjykatës ku ai ushtron detyrën”.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar rezulton se, organet kompetente për menaxhimin e shërbimit civil pranë gjykatave të vendit, e në rastin konkret pranë Gjykatës së Lartë është Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili miraton modelin e strukturës dhe organikës të kësaj gjykate, të cilat më pas kalojnë për miratim tek Këshilli i Gjykatës.

Gjithashtu, sipas përcaktimeve ligjore të lartpërmendura, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka tagrin ligjor për të hartuar listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, mbi bazën e të cilës kryhet pranimi në shërbimin civil gjyqësor.

Ndërsa bazuar në nenin 80, të ligjit 98/2016, “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, sanksionohet se, organi kompetent ligjor për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësit e tjerë civil gjyqësorë, në rastin konkret, për dy punonjëset në pozicionet e “*Përgjegjësit të Sektorit*”, kërkuar në Vendimin Paralajmërues nr.160, datë 10.12.2019, të Komisionerit, është Këshilli i Gjykatës pranë Gjykatës së Lartë.

Sa më lart, në kushtet kur, për shkak të vakancave të krijuara në Gjykatën e Lartë, mungon numri i nevojshëm për përbërjen e Këshillit të Gjykatës, referuar nenit 27, të ligjit nr. 98/2016, si dhe në situatën kur, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është përcaktuar ende modeli i strukturës dhe organikës për këtë gjykatë, e rrjedhimisht nuk është hartuar ende lista e nëpunësve civilë gjyqësorë, vlerësoj se, afati për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 160, datë 10.12.2019, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Gjykata e Lartë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, duhet të shtyhet, deri në përmbushjen e detyrave ligjore nga secili organ i ngarkuar nga ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, kreu IV “*Rishikimi*”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 160, datë 10.12.2019.
2. Detyrat e përmendura në dispozitivin e Vendimit nr. 160, datë 10.12.2019, duhet të përmbushen nga institucioni i Gjykatës së Lartë, sipas afatit të lënë në këtë vendim, deri në datë 31.03.2020.

3. Për këtë vendim të njoftohet Gjykata e Lartë dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha